

**VENDIM**  
**Nr. 287, datë 19.5.2021**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 710, DATË 21.8.2013, TË KËSHILLIT  
TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SISTEMEVE TË  
RUAJTJES SË INFORMACIONIT, VAZHDUESHMËRISË SË PUNËS DHE  
MARRËVESHJEVE TË NIVELIT TË SHËRBIMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, dhe të pikës 3, të nenit 21, të ligjit nr. 10273, datë 29.4.2010. “Për dokumentin elektronik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në shkronjën “a”, të pikës 2, të vendimit nr. 710, datë 21.8.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, fjalët “... jo më e shkurtër se 4 (katër) vjet.”, zëvendësohen me “... jo më e shkurtër se 2 (dy) vjet.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Erion Braçe**